

## SHENIME BIBLIOGRAFIKE

- 1) *Hans Krahe, «Die Sprache der Illyrier.»* Zweiter Teil: *Carlo De Simone, Die messapischen Inschriften. Jurgun Untermann, Die messapischen Personennamen* (= Hans Krahe, *Gjuha e Ilirëve*. Pjesa e dytë: Carlo De Simone, *Mbishkrimet mesape*. J. Untermann, *Emrat mesape të personave*). Wiesbaden, Otto Harrassowitz, 1964, 361 f.

Përmbajtja: f. V-VII Parathënje (H. Krahe); f. 1-151 Mbishkrimet mesape (C. de Simone); f. 151-213 Emrat mesape të personave (J. Untermann); f. 215-221 Treguesit; f. 225-226 Vendet ku janë gjetë mbishkrimet; f. 227-228 Vendet ku ruhen ato; f. 231-239 Riprodhim fotografik i mbishkrimeve, f. 360-361 dy harta.

Përmblihdhen këtu dy punime mbi mbishkrimet dhe onomastikën mesape, kontribute për njohjen e gjuhës mesape, degë kjo e ilirishtes. Ato kanë dalë si pjesë e dytë e monografisë së ilirologut të njohur Hans Krahe, botuar 12 vjet më parë. «Die Sprache der Illyrier. I. Die Quellen (= Gjuha e Ilirëve. I. Burimet), Wiesbaden 1955, 120 f. Hans Krahe, si dihet, është autori i dy repertorëve të gjerë të onomastikës ilire «Lexikon altillyrischen Personennamen» (= Fjalor i emrave të vjetër ilirë të njerëzve) 1929 dhe «Die alten balkan-illyrischen geographischen Namen (= Emrat e lashtë gjeografikë ilirë të Ballkanit) 1925 dhe i një numri të madh monografish, studimesh, kontributesh, artikujsh që u kushtohen ilirishtes e ilirëve ose u kanë dhënë atyre një vend të rëndësishëm. Duke u nisur nga të dhënat e onomastikës ilire, sidomos të toponimeve ilire, Hans Krahe arrinte në përfundime largvajtëse për sa i përket shtrirjes së ilirëve. Çfaqjen e emrave të vendeve ilire gjithkund ai e vështronte si dëshmuese të një popullsie të dikurshme ilire në trevën përkatëse. Në bazë të përhapjes së tyre, ai pothuajse gjithë Evropën, me përjashtim të veriut thjesht gjermanik, dhe një pjesë të Azisë së Vogël, i mirrte si një hapësirë ilire. Po vitet e fundit mendimet e tia nisën të pësojnë evolucion dhe ai të ketë një qëndrim më të rezervuar ndaj të dhënave onomastike të karakterizuara si ilire. Studimi i emrave të rrjedhave të ujit, të cilëve ai u dha një rëndësi të veçantë, e shpuri në tëzën se ekziston një hidronomi e lashtë e Evropës absolutisht e njëjtë, me prejar-dhje indoevropiane. Toponime të marra si ilire zunë të mos vështrohen më si të tilla, po si indoevropiane të hershme.

Në parëthënjen e librit që po recenzojmë, Hans Krahe formulon një sërë rektifikimesh e vërejtjesh kritike lidhur me pikëpamjet e tia të deritanishme dhe me metodologjinë e përdorur prej tij e bërë zotëruese në iliristikën e gjertanishme, vë në pyetje vlerën e përfundimeve të arritura dhe shtron nevojën e një rishqyrtimi rrënjësor në bazë kriteresh më të sigurt. Po japim gjerësisht përmbajtjen e kësaj parathënjeje për arsye të rëndësishme që ka:

Ky vijim i «Die Sprache des Illyrier», në kundërshtim me planin që ishte lënë të kuptohej në vëllimin e parë, del me një vonesë të madhe, por edhe me formë të

ndryshuar, përkatësisht me një përmbajtje tjetër. Të dyja këto e kanë burimin në të njohurit se emërtimi «ilir» ashtu gjerë si e kemi përdorur ne edhe në vëllimin e parë, sot nuk mund të përdoret më; edhe kjo e ka arësyeën e vet përsëri në faktin se ne — si edhe më të shumtët e studjuesve të tjerë — ju shtriuam (= ramë viktimë të) një arësyesimi metodik të gabuar (me mjaft pasoja nga shumë anë).

Ka qenë besuar që, nëse një emër e përveçëm i dëshmuar për territorin e banuar prej ilirëve në verilindje të gadishullit ballkanik, të cilin mendohej se duhej, me arësye të shëndosha, ta mbanimpër ilir, ndjehej me tingëllim të njëjtë edhe në vende të tjera (shpesh shumë të largëta), duhej që edhe ky të merrej si «ilir». Kështu u gjet p.sh. një *Amantia* homonime me toponimin e ilirishtes jugore *Amantia* jo vetëm në Brutium në Italinë jugore dhe si bazë e emrit të fisit panonik *Amantini*, po më se një herë edhe si emër lumi në Francë (sot *Amence*: 1° afluent i Aube, 2° afluent i Saone), dhe të gjithë këta emra pak a shumë pa ngurrim ju mvëshën ilirëve.

Kështu, në bazë të rasteve të njëjlojta të panumërta u arrit pastaj që «ilirishtes» dhe bartësve të saj «ilirëve» t'u jepej një shtrirje e dikurshme mjaft e gjerë dhe prej kësaj të nxirren për parahistorinë e Evropës përfundime që shkojnë shumë larg. Së fundi, pasi ilirët identifikoheshin me të ashtuquajturën Urnenfeldenkultur (kulturë e varrezave me urna), u fol edhe për një shtet botëror të njerzëve të varrezave me urna.

U bë pak nga pak gjithmonë e më e qartë se me këtë nuk ishte qëlluar në shenjë dhe zu t'u jepet të drejtë atyre që ngrinin kundra këtyre përfundimeve vërejtjen e «panilirizmit».

Metoda e përdorur e krahasimit të emrave të përveçëm ishte në rregull e në vendin e vet. Po si mundi ajo të shpjerë në përfundimin e gënjeshtërt të një shtrirjeje të dikurshme tepër të gjerë të ilirishtes? Në një numër shumë të madh rastesh nuk është për të dyshuar në përkimin e emrave përkatës dhe në prejardhjen e tyre pak a shumë të njësishtme, pra barazimet si të tilla në themel qëndrojnë; gabimi fatal ka qenë në etiketimin e tyre si «ilirë». Për ta sqaruar sa më mirë këtë lajthitje dhe për ta ndrequr atë që sa kisha fuqinë, fillova kërkimet në fushën e emrave më të vjetër të rrjedhave të ujit t'Evropës. Ato më shpunë të zbuloj atë që unë quajta «Hidronimi e hershme evropiane». Këtu kemi të bëjmë me një emërtim indoevropian që i përket periudhës para formimit të gjuhëve të veçanta indoevropiane, përfshin në thelb gjithë hapësirën e gjuhëve të mëvonshme indoevropiane perëndimore dhe i shtrin rrënjët gjer në mijëvjeçarin e dytë para epokës sonë. Një pjesë e madhe e emrave të ujërave e dalë nga kjo hidronomi (si edhe e emrave të vendbanimeve të rrjedhur prej tyre) vazhdon të jetojë në kuadrin e gjuhëve të veçanta indoevropiane perëndimore të mëvonshme; poende, sipas modeleve «indoevropiane të hershme» edhe për një kohë të gjatë, në periudhën e gjuhëve të veçanta, vijuan të formohen gjithnjë emra të rinj.

Dihet vetvetiu rëndësia që ka për problemin e «ilirishtes» qenia e një hidronimie të hershme indoevropiane (prej së cilës kanë dalë edhe emra të shumë vendbanimesh). Një emër lumi si *Amantia* (>Amence) në Francë nuk do të jepet më si «ilir» me argumentimin se, pak a shumë rastësisht, ka edhe në veriperëndim të Ballkanit emra «Amantia». Ka më shumë të ngjarë që këta dy emra, si edhe dy emrat e tjerë nga Italia e Panomia që përmendëm, të jenë pasardhës të drejtë përdrejt ose të tërthortë të një emërtimi indoevropian të hershëm të përbashkët. Ato hyjnë në një seri, morfologjike me *Amara*, *Amasia*, *Amata* e tjerë emra të ngjashëm me ta, d.m.th. në një sistem që vërtetohet nga shumë seri të tilla, të formuara gjithnjë në mënyrë të njëjlojtë. Dhe nga ky «sistem» nuk lejohet të veqohet një emër si *Amantia* (dhe shumë të tjerë të njëjlojtë).

Këtë del që një pjesë e shenuar e emrave të ndeshur në Iliri ose jashtë saj, të cilët është besuar se mund të përdroreshin si bazë për të fituar një ide të ilirishtes

dhe të gramatikës së saj, nuk mund të përdoren më në këtë vështrim ose mund të përdoren vetëm në rrethana krejt të veçanta. Si pasoje tërë materiali gjuhësor e onomastik i mbledhur gjer më tani e i marrë në konsideratë në kuadrin e problemit ilir, duhet t'i nënshtrohet një shqyrtimi të ri kritik për të përcaktuar çfarë «mbetet», për ta vënë në një bazë të re të ashtuquajturën «çështje e ilirëve» në tërësi.

Duhet pasur parasysh edhe një gjë tjetër: Duket se territori në veriperëndim të Ballkanit (dhe në trevat pandërmjetesisht fqinje) i vështruar si ilir nuk ka paraqitur një njësi gjuhësore aqë të mbyllur si shpesh është menduar. Edhe për këtë arësyje janë të nevojshëm një sistemim dhe një shtresëzim i ri i materialit gjuhësor përkatës.

Por nëse duhet filluar, si të thuash, nga e para, duhet shpresuar për sukses më tepër atje ku kemi tekste të lidhura, të vijueshme, qoftë edhe të një vëllimi të vogël, d.m.th. tek mbishkrimet mesape. Ja përse atyre u duhej kushtuar ky vëllim, pavarësisht nga fakti në se rezultati përfundimtar i kërkimeve tona do të lejojë që këto mbishkrime të konsiderohen edhe këndeje e tutje, ashtu si ka qenë rasti përgjithësisht deri tani, se i takojnë ilirishtes ose se vetëm i qëndrojnë shumë afër asaj. Me bazën e fituar në këtë mënyrë duhet pastaj të ndërmerret një shqyrtim e vlerësim i ri i materialit onomastik të emrave të vendeve e të personave që është trashëguar nga koha e lashtë (në lidhje me greqishten ose latinishten).

Në punimin e C. de Simone vjen së pari një studim i imët mbi kronologjinë e alfabetit dhe të mbishkrimeve mesape, përpunim i disertacionit të doktoratit që ka hartuar autori nën udhëheqjen e Prof. Dr. M. Pallottino e që ka mbrojtur në Universitetin e Romës më 1956. Më pas botohen mbishkrimet me komantarim epigrafik, të renditura kronologjikisht sipas përfundimeve të studimit parapsis, gjithsej 225 mbishkrime. Në dy shtojca ipen në njerën mbishkrimet me pak germa të mangëta ose me kronologji të pasigurtë a të lekundshme, 112 mbishkrime, në tjetrën një listë referuese e mbishkrimeve të pamarrura në konsideratë, pse të rreme a me prejardhje jomesape a të pasigurtë.

Kështu C. de Simone, pas Fr. Ribezzos («Corpus Inscriptionum Messapicarum» 1922-1935) e pas O. Parlangelit («Le iscrizioni messapiche», Messina, 1960), na jep një repertor të ri të plotë të mbishkrimeve mesape. Kriteret e reja mbi të cilat është ndërtuar (parashtrimi në rendin kronologjik dhe ilustrimi tërësor i mbishkrimeve), vemendja më e madhe kushtuar aspektit paleografik të teksteve, që i ka lejuar të ndreqë disa gabime dhe zbrazi të leximeve të paraardhësve, i japin një vlerë të veçantë këtij Korpusi të ri. Riprodhimi tërësor fotografik i objekteve ndihmon shumë kontrollin e leximeve dhe studimin arkeologjik-historik të materialit (gurë varri, enë, përkushtime etj.) që mban mbishkrimin.

Për secilin mbishkrim ipen bibliografia, përkshkrimi i objektit që ka mbishkrimin (materiali, përmasat, topografia), vërejtjet paleografike e filologjike (lidhur me leximin), transkriptimi i tekstit, komentari epigrafik e leximet e ndryshme. Autori s'është marrë me përmbajtjen filologjike gjuhësore të mbishkrimeve. Vlerësimi gjuhësor i ndarjes kronologjike të mbishkrimeve, thotë autori në Parafjalën e tij (f. 3) mbetet për t'u bërë në një punim të veçantë që duhet të përmbajë edhe një leksikon të mesapishtes.

Vepra e C. de Simone kështu vjen të plotësojë veprën e sipërpërmendun të O. Parlangelit, po nuk e zëvendëson atë, pse s'ka diskutimin filologjik-gjuhësor dhe etimologjik. Kritika ka vënë re se edhe në këtë veper leximi le herë herë për të dëshiruar, duke i shpëtuar autorit një serë gabimesh, po më pak se Parlangelit.

Pjesën kryesore të përmbajtjes së mbishkrimeve mesape, si dihet, e përbëjnë emrat e personave. Për këtë arësyje në vëllimin që po recenzojmë është futur edhe monografia e J. Untermannit mbi antroponimet mesape. Është kjo një orvatje analize formale — morfologjike me interes, me vështrim të vlerës funksionale të materialit

onomastik të mbishkrimeve, një përpjekje sistematizimi e antroponomisë mesape. Në pjesën e parë trajtohen funksioni dhe forma e emrave të meshkujve, dallohen ata sipas përbërjes së tyre në emërtime shumëgjymtyrëshe e njëgjymtyrëshe, sipas rolit në emra të parë e në mbiemra (llagape) etj., dallohen format e gjindores e të emërores; në pjesën e dytë vështrohen forma dhe funksioni i emrave të grave. Në pjesën e tretë kemi një paraqitje të prapashitesave të emrave duke u dalluar ata të emrave të parë nga ata të mbiemrave (llagapeve). Autorin nuk e intereson kuptimi i emrave as mënyra e lidhjes së tyre etimologjike me mesapishten. Ky vështrim i njëanshëm, me gjithë meritat që ka, siç e ka vënë në dukje edhe kritika, nuk jep rezultatet e dëshiruara. Është thënë me të drejtë se materiali onomastik nuk duhet veçuar nga materiali gjuhësor, nuk duhet parë në vetvete i veçuar, po i integruar në kontekstin e tij të natyrshëm, në lidhje me gjuhën e përditshme të mesapëve, me krahasime me antroponominë e popullsive farefise, në radhë të parë të ilirëve të Ballkanit e të trakëve (I.I. Russu, recension botuar në «Cercetări de linguistica», X, 1965, 2, f. 376-382).

Në përgjithësi mund të thuhet se me veprën e re të C. de Simone e J. Untermann studjuesve u ipen mjaft elemente të reja e më të sigurta që vijnë e saktësojnë a plotësojnë të dhënat e deritanishme për materialin epigrafik të mesapishtes dhe ndihmojnë të fitohet një njohje më e mirë e më saktë e gjuhës mesape në përgjithësi. Në parathënie H. Krahe premtonte se do të vinte më pas një vëllim i tretë, ku ilirologu i shquar vetë do të përmbledhte rezultatet e shqyrtimit të mbishkrimeve duke parashtruar një skicë të gramatikës mesape sipas të dhënave të tyre. Nuk dimë në se arriti ta realizojë këtë plan, para se ta rrëmbejë vdekja një vit e ca më parë.

2) Joseph Wiesner, *Die Thraken. Studien zu einem versunkenen Volk des Balkanraumes* [= Trakët. Studime mbi një popull të zhdukur të zonës së Ballkanit] (Urban-Bücher. Die wissenschaftliche Taschen-buchreihe, herausgeben von Fritz Ernst, n. 41). Stuttgart, W. Kohlhammer Verlag, 1963 256, f. 12 figura.

Përmbajtja: Parathënia f. 5-8; Kap. I. Kufijtë dhe fiset f. 11-23; Vendi dhe banorët f. 24-41; III. Shtresat gjuhësore f. 42-44; IV. Vendi i trakëve në kohën greke f. 79-148; V. Trakët në kohën romake f. 149-196. Shënime f. 197-227. Harta dhe ilustracione, f. 228-229. Bibliografia f. 250-256.

Vepër drejtuar një publiku të gjerë, botuar në një koleksion librash xhepi. Recension me vlerësim negativ botuar në revistën «Cercetări de lingvistica», Kluzh, Rumani, X, 1965, n. 1, f. 229-235, nga shkencëtari rumun I.I. Russu, autor vetë i një monografie mbi gjuhën e trako-dakëve (1959), dhe i disa studimeve mbi ilirët: Nuk është një monografi origjinale me ndonjë kontribut personal, po punim i karakterit kompilativ, me përmbledhje të të dhënave të burimeve antike e të letërsisë ekzistuese, pa një trajtim kritik të tyre. Shkruar qartë e bukur, po me shumë të meta, pa saktësinë e rreptë shkencore, me pohime të shumta të diskutueshme, ndonjë herë edhe të gabuara, me mjaft pseudoetimologji. Bibliografia e pasur, po me mjaft mungesa, sidomos për anën gjuhësore e për letërsinë më të re.